



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME

Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-10309/22 datë: 22.04.2022



Npi – 01/102 datë: 27.04.2022

Duke u bazuar në nenin 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shitmes, si dhe në bazë të nenit 3.4 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Kryesuesi i Komitetit bën këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 27.04.2022 (e mërkurë) në ora 14.00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje përveq anëtarëve të Komitetit për Komunitete: Besnik Seferi, Shkurte Mustafa, Rrezartë Ramadani, Muhamet Mehmeti, Shkurte Behluli, Arton Demiri, Bajram Ilazi, kanë marrë pjesë edhe: Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, përfaqësues nga UNMIK-ut, z.Nevzat Qorrolli dhe Gazmend Piraj, përfaqësues nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri, dhe Florent Sadiku. Zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, Praktikantja, znj.Valmira Hoxha. Mbledhjen e parë e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Komitetit për Komunitete,
2. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Komitetit për Komunitete

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pike.

z.Gazmend Piraj; Përshëndetje, unë deshta vetëm të ju informojë se nuk ka nevojë për Zëvendës Kryesues, sepse nuk e parasheh ligji.

z.Bajram Ilazi; Përshëndetje, unë e përfaqësojë shoqërinë civile nga Komuniteti Ashkali në këtë Komitet, të cilit i urojë punë të mbarë. Unë mendoj se zgjedhja e një Zëvendës Kryesuesi është në interes të Komitetit për të funksionuar më mirë, edhe pse ligji as nuk e ndalon e as nuk thotë që duhet të zgjidhet. Unë jam që të zgjidhet një Zëvendës Kryesues.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, unë e përfaqësojë Komunitetin Ashkali në këtë Komitet, dhe jam që ta zgjedhim edhe një Zëvendës Kryesues të Komitetit.

znj.Shkurte Behluli; Përshëndetje, edhe unë e përfaqësojë Komunitetin Ashkali, dhe jam që ta zgjedhim Zëvendës Kryesuesin.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, unë e përfaqësojë Komunitetin Romë.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, unë jam anëtarë i Kuvendit në Komitetin për Komunitete.

znj.Shkurte Mustafa; Përshendetje, unë jamë anëtare e Kuvendit në Komitetin për Komunitete.
znj.Rrezartë Ramadani; Përshendetje, jamë anëtare e Kuvendit në Komitetin për Komunitete.
*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi rendin ne ditës.**

z.Besnik Seferi; Po e marrë fjalën për heren e dytë sepse dua ti falenderojë përfaqësuesit e OSBE-së dhe organizatave e tjera për këshillat që i dhanë për Zëvendës Kryesuesin. Unë mendojë se ne mundemi me e zgjedhë dhe mundemi mos me e zgjedhë Zëvendës Kryesuesin e Komitetit për Komunitete. Sa i përket orarit të mbledhjeve duhet me e bërë një gjithëpërfshirje.

z.Arton Demiri; Unë mendojë se ne kemi nevojë si Komitet që ta zgjedhim një Zëvendës Kryesues, sepse e kemi pas edhe më parë.

z.Bajram Ilazi; Unë mendojë se përderisa nuk bëjmë shkelje ligjore, pse most a zgjedhim edhe një Zëvendës Kryesues.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi që Komiteti për Komunitete të zgjedhë edhe një Zëvendës Kryesues.**

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Meqenëse u vendos që Komiteti për Komunitete të ketë edhe Zëvendës Kryesues unë e hapi diskutimin për të dhënë propozimet e juaja për Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin e Komitetit për Komunitete.

z.Muhamet Mehmeti; Unë e propozojë Bajram Ilazin për Kryesues.

z.Arton Demiri; Edhe unë e propozojë Bajram Ilazin për Kryesues.

znj.Shkurte Behluli; Edhe unë e propozojë Bajram Ilazin për Kryesues.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht, zgjodhi z.Bajram Ilazin - Gjyrkovc, Kryesues i Komitetit për Komunitete, përfaqësues nga komuniteti Ashkali.**

z.Bajram Ilazi; E falenderoj Komitetin për Komunitete për besimin e dhënë. Unë bashkë me juve do të punojë dhe do të mundohem që punën ta bëjë sa më mirë, në këtë rast nuk dua ta zgjasë më shumë këtë diskutim por edhe njëherë ju falenderojë për besimin e dhënë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Tani po i presim nga ju propozimet për zgjedhjen e Zëvendës Kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

z.Bajram Ilazi; Unë e propozoj Muhemet Mehmetin për Zëvendës Kryesues.

z.Besnik Seferi; Edhe unë e propozoj Muhemet Mehmetin për Zëvendës Kryesues, sepse e njoh si person dhe si familje e mirë. Unë besoj se kemi me qenë të gjithë unik për ta aprovuar.

z.Arton Demiri; Edhe unë jamë që Muhemet Mehmeti me u zgjedhë për Zëvendës Kryesues.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht, zgjodhi Zëvendës-Kryesuesin e Komitetit për Komunitete, Muhamet Mehmetin - Shtime, përfaqësues i komunitetit Ashkali.**

Pika 2

Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pike.

z.Arton Demiri; Unë desha ta bëj një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit në këtë mbledhje, por posaqërisht për OSBE-në, sepse gjithnjë na ka përkrahur.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Unë në fund dëshiroj që të uroj zgjedhjen e Bajram Ilazit për Kryesues dhe zgjedhjen e Muhamet Mehmetit për Zëvendës Kryesues të Komitetit për Komunitete, uroj që të keni suksese bashkëpunim dhe punë të mbarë.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, mbledhjen e Komitetit për Komunitete e përfundoi në ora 14.34 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

